



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 20.12.2017, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjëni Thaçi-Dragusha, Sergjan Mitroviç dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrësit tjerë: Nehat Dervishi, OSBE; Blerta Bejtullahu, EUSR/EU; Agnesa Haxhiu, KDI; Shefki Kastrati, NDI; Fillesë Demaku, Besmir Radoniqi, Valtrim Hasani, praktikantë dhe media.

Nga zyra e komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5 dhjetor 2017;
3. Përcaktimi i datës për shqyrtimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi;
4. Prezantim i hulumtimit parlamentar mbi analizën buxhetore të MPJ-së dhe MDIS;
5. Përcaktimi i delegacionit të Komisionit për pjesëmarrje në programin trajnues në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5 dhjetor 2017

Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 5 dhjetor 2017.

3. Përcaktimi i datës për shqyrtimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

Vjosa Osmani-Sadriu, tha se kjo mbledhje është thirrur, që në konsultim me anëtarët e komisionit, të caktohet data se kur do të shqyrtohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për kufirin shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Ajo njoftoi se Rregullorja e Kuvendit parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjeve në komisione nuk mund të bëhet pa kaluar 2 javë pune, por as më vonë se 4 javë pune, nga data e shpërndarjes së materialit. Lidhur me këtë projektligj, tha se është një temë e ndjeshme dhe është mirë që të gjithë anëtarët të jenë të pranishëm ditën kur të shqyrtohet. Kryetarja propozoi që komisioni të mblidhet për ta shqyrtuar këtë projektligj më 26 ose më 27 dhjetor 2017, ose më 3 ose 4 janar 2018, pasi që sipas Rregullores së Punës, komisioni duhet ta përfundojë këtë çështje, deri më 5 janar 2018.

Time Kadrijaj, tha se agjenda për shqyrtimin e projektligjeve në komision, caktohet nga kryetarja e komisionit dhe nuk duhet të bëhet përjashtim as për këtë ligj. Ajo theksoi se duhet të respektohet afati dhe korniza ligjore për shqyrtimin e këtij projektligji dhe se deputetët e kanë obligim që të jenë prezentë ditën që caktohet për ta shqyrtuar këtë projektligj.

Vjosa Osmani, tha se shqyrtimi i këtij projektligji nuk është si shqyrtimi i projektligjeve tjera, për shkak të rëndësisë së tij. Deputetët kanë mundësi të paraqesin argumente konkrete, para se t'i procedohet Kuvendit. Ajo shtoi se komisioni do ta shqyrtojë përmbajtjen e marrëveshjes dhe pret që deputetët të japin argumentet e tyre, se pse votojnë në mënyrë të caktuar.

Danush Ademi, sa i përket datave të propozuara për mbajtjen e mbledhjes për shqyrtimin e projektligjit, tha se pajtohet të mbahet në cilëndo datë që vendos komisioni.

Zafir Berisha, shprehu mendimin se nuk ka qenë e nevojshme që të futet në rend dite kjo pike, pasi që deputetët kanë përgjegjësi të jenë në mbledhje, kurdo që thirret ajo, sidomos kur diskutohen tema të ndjeshme si kjo.

Vjosa Osmani, tha se meqë kjo është një temë e rëndësishme, është praktikë e mirë që anëtarët e komisionit të konsultohet lidhur me atë se kur janë të gatshëm ta shqyrtojnë këtë çështje. Ajo më tej shtoi se është mirë që edhe deputetët, që për herë të parë kanë fituar mandatin, të kenë mundësi dhe kohë të mjaftueshme të njoftohen me materialin e nevojshëm.

Visar Ymeri, tha se është e rëndësishme që të ftohet dikush nga Qeveria për ta prezantuar marrëveshjen dhe raportin e fundit të Komisionit Shtetëror, të mandatuar nga Kryeministri. Ai, po ashtu, shtoi se ka nevojë për informata shtesë, sesi është arritur marrëveshja e parë, pasi që nuk ka një elaborat të saktë të procesit, i cili demantohet me të gjitha pikat nga raporti i fundit i Komisionit Shtetëror. Z. Ymeri shprehu mendimin se do të kishte qenë e udhës që Kryeministri të jetë i pranishëm në mbledhje të komisionit, me rastin e shqyrtimit të këtij projektligji.

Dukagjin Gorani, tha se memorandumit shpjegues i projektligjit paraqet një interpretim të pasaktë të rrjedhës së kësaj ngjarjeje, që prej ditës që është nënshkruar kjo marrëveshje. Ai më tej shtoi se në memorandumit shpjegues të këtij projektligji nuk përmendet liberalizimi i vizave, dhe nëse objektivi i ratifikimit të kësaj marrëveshjeje është liberalizimi i vizave, atëherë pse nuk përmendet në këtë memorandum? Sipas tij, kjo ngjall dyshime se kurrë nuk është bërë fjalë për liberalizim të vizave dhe se ndërlidhja e këtyre çështjeve është një lloj spekulimi. Duke iu referuar pikës 6 dhe 7 të memorandumit shpjegues, ku thuhet se projektligjet që bëjnë ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nuk e kalojnë hapin e paraparë për konsultim publik, z. Gorani tha se sipas këtyre pikave, anashkalohet ideja e konsultimit me publikun dhe diskutimi që po bëhet në komision është i panevojshëm, meqë për këtë projektligj nuk ka nevojë të konsultohen deputetët, dhe nëse bëhet fjalë

për një qëndrim të tillë, atëherë pse duhet të merret një përgjegjësi për diçka që nuk pyetesh. Z. Gorani paraqiti qëndrimin e Lëvizjes Vetëvendosje, sipas të cilit, ky është një proces i dëmshëm, i papranueshëm dhe do të kundërshtohet në çdo fazë të procedimit të tij.

Vjosa Osmani, tha se kemi para vetes një marrëveshje, për të cilën raporti i fundit i Komisionit Shtetëror thotë se përbën tri vepra penale: falsifikimi i hartave, fshehja e dokumenteve zyrtare, cenim i tërësisë territoriale e shumëçka tjetër dhe për këtë duhet të japin përgjigje organet e hetuesisë. Kryetarja u pajtua që të ftohet dikush nga Qeveria, që të japë përgjigje në këto pyetje, sepse njëri raport thotë se nuk ka falsifikim, kurse raporti tjetër thotë se ka falsifikim të dokumenteve. Ajo propozoi që të ftohet Kryeministri, së bashku me Komisionin Shtetëror në Komision, për t'iu përgjigjur pyetjeve të anëtarëve të komisionit, më datë 26 dhjetor 2017.

Elmi Reçica, shprehu mendimin se është më mirë që të ftohet ministri i Punëve të Jashtme, në mënyrë që të mos komplikohet situata.

Vjosa Osmani, duke iu referuar kërkesës së deputetit Reçica, tha se ministri i Punëve të Jashtme nuk ka marrë pjesë në negociimin e marrëveshjes dhe nuk mund të ketë njohuri sa Kryeministri, pasi që sa ka qenë deputet është marrë me këtë çështje. Komisionit i duhen përgjigje rreth falsifikimeve, rreth disa konkluzioneve që i ka arrit Komisioni Shtetëror i tanishëm, sepse nuk mund të procedohet një material në Kuvendin e Kosovës me pretendime për vepra penale.

Visar Ymeri, shprehu mendimin se nuk mund të kemi diskutim, pa qenë i pranishëm Kryeministri dhe kryetari i Komisionit Shtetëror. Z. Ymeri është i pajtimit për ngritjen e dyshimeve që janë përmendur në raportin e fundit të Komisionit Shtetëror për falsifikim të dokumenteve nga komisioni i kaluar dhe se ky është një problem jashtëzakonisht shqetësues. Ai, më tej, tha se komisioni nuk ka kompetencë që të merret me këtë çështje në aspektin penal, por shprehu mendimin se përmes diskutimeve dhe nga procesverbali që do të dalë nga ajo mbledhje, mund të saktësohen deri diku ato dyshime dhe pastaj prokuroria duhet ta trajtojë këtë çështje. Ai u dakordua që mbledhja e komisionit të mbahet më 26 dhjetor, mirëpo propozoi që komisioni të jetë më fleksibil dhe t'i përshtatet edhe mundësisë së Kryeministrit.

Zafir Berisha, tha se do të ishte mirë të kërkohej nga Qeveria dhe organet përkatëse, se a janë të vërteta pretendimet për falsifikim të hartave?

Evgjeni Thaçi, nuk pajtohet që ky projektligj është si projektligjet tjera, pasi që për këtë projektligj janë prishur koalicionet dhe ka rënë Qeveria. Ajo, po ashtu, tha se nuk e kupton se pse këtij projektligji i është bashkëngjitur raporti i Komisionit të ri shtetëror, i cili mision primar e ka pasur vlerësimin e komisionit paraprak. Znj. Thaçi-Dragusha, shprehu mendimin se adresa e fundit e këtij raporti ka qenë Qeveria, mirëpo nëse është vendosur që të shqyrtohet në komision, atëherë komisioni duhet ta shqyrtojë edhe raportin e komisioni ad-hoc, të emëruar nga ish-Presidentja Jahjaga, si dhe deklaratën e Departamentit Amerikan të Shtetit. Lidhur me këto raporte, tha se kanë rëndësi të madhe dhe nuk mund të anashkalohen.

Vjosa Osmani, pajtohet që deputetët duhet t'i kenë të gjitha materialet që janë përgatitur lidhur me këtë marrëveshje. Këtu duhet të përfshihet raporti i Komisionit ad-hoc ndërkombëtar të emëruar nga ish-Presidentja Jahjaga, Deklarata e Departamentit Amerikan të Shtetit, si dhe raporti i komisionit të udhëhequr nga akademik Hivzi Islami, për matjen e territorit.

Visar Ymeri, tha se duhet të bëhet një ndarje në mes të dokumenteve, të cilat kërkojnë deklarimin e deputetëve dhe dokumenteve që mund të jenë informuese. Ai tha se dokumentet që kërkojnë deklarimin e deputetëve janë marrëveshja dhe raporti i Komisionit për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Vijës Kufitare, ndërsa dokumentet tjera janë informuese.

Vjosa Osmani, tha se komisioni ka obligim t'i jap rekomandim seancës vetëm për Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes. Ajo, më tej, shtoi se komisioni mund ta shqyrtojë cilindo raport, por efekt juridik nuk ka, sepse në seancë votohet vetëm Projektligji për ratifikimit të marrëveshjes dhe në aneks e ka tekstin e marrëveshjes. Lidhur me vendimin e Kryeministrit për emërimin e Komisionit Shtetëror, njoftoi se janë nxjerrë dy vendime, vendimi i parë thotë se emërohet Komisioni për Shënjimin e Kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, kurse vendimi i dytë, i cili nuk e shfuqizon vendimin e parë, thotë se komisioni është emëruar për ta vlerësuar punën e komisionit të vjetër. Sa i përket kësaj, tha se sipas Ligjit për shënjimin e kufijve shtetërorë, askush nuk ka të drejtë të emërojë komisione për të vlerësuar komisione paraprake dhe se për këtë mund të diskutohet në ditën kur vjen Kryeministri. Ajo tha se sipas Rregullores, komisioni e voton marrëveshjen dhe i rekomandohet seancës për votim ose mosmiratim.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, tha se meqenëse projektligji mbështetet në marrëveshjen dhe raportin e komisionit të parë për shënjimin e kufirit, të gjitha raportet tjera kanë rëndësinë e njëjte informuese, prandaj nuk ka asgjë të keqe që të sillen informacione shtesë, në mënyrë që ne t'i diskutojmë.

Aida Dërguti, pajtohet që të sillen të gjitha materialet shtesë që janë informuese për çështjen e demarkacionit. Ajo theksoi se problem kryesor paraqet nëse komisioni i ri ka gjetje për çfarëdo veprë penale, e ne si komision ta procedojmë më tej në Kuvend, një marrëveshje të tillë. Sqarimi kryesor mbetet me Kryeministrin dhe komisionin aktual, që ta dimë nëse gjatë procesit është bërë ndonjë veprë penale.

Visar Ymeri, theksoi se shteti i Kosovës duhet ta ketë një komision të përhershëm për shënimin e kufirit, i cili do të ishte kompetent për të gjitha shënjimet e nevojshme të kufirit të shtetit. Ai tha se komisioni i ri i drejtuar nga prof. Bulliqi, nuk është komision që e bën vetëm vlerësimin e punës së komisionit të mëparshëm, por një komision që e zëvendëson atë, sepse është shkarkuar komisioni i drejtuar nga z. Meha dhe është zëvendësuar me komisionin e drejtuar nga z. Bulliqi. Kjo, tha ai, ka domethënie institucionale. Raporti i komisionit të ri e hedh poshtë faktikisht marrëveshjen për demarkacion, me pretendimet se ka falsifikim të dokumenteve në procesin e negocimit me Malin e Zi, e deri te gabimet e caktuara gjatë procesit të negocimit me Malin e Zi. Z. Ymeri tha se nuk është e rastësishme që raporti i ri do të vijë së bashku me Projektligjin nga Qeveria, prandaj propozoi që për këtë çështje të dëgjohet edhe Kryeministri.

Vjosa Osmani, tha se Qeveria Kosovës po i vendos në raport të barabartë edhe komisionin e drejtuar nga z. Bulliqi dhe atë nga z. Meha, pasi që i ka përcjellë për Kuvend, të dy raportet.

Elmi Reçica, theksoi se çështja e emërimit të komisionit të ri, se a i ka kaluar mandati komisionit paraprak, e po ashtu çështja e veprave penale, e shitjes së të territorit, nuk janë çështje tonat, por çështje të drejtësisë. Propozoi që komisioni të vendosë se kur do të caktohet mbledhja e radhës e komisionit, kush do të ftohet, ngase si praktikë ftohet ministri i linjës dhe kërkoi që paraprakisht t'i kenë të gjitha informacionet.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë,

P e r f u n d i m

Mbledhja e komisionit për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-028 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të ftohet për dt. 26 dhjetor 2017.

Me këtë rast, të ftohet Kryeministri, z. Ramush Haradinaj dhe Komisioni Shtetëror, për vlerësimin e punës së ish- Komisionit Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror Kosovë-Mali i Zi, i kryesuar nga z. Bulliqi.

4. Prezantimi i hulumtimit parlamentar mbi analizën buxhetore të MPJ-së dhe MDIS

Vjosa Osmani, njoftoi anëtarët e komisionit se është punuar një hulumtim, mbi analizën buxhetore të MPJ-së dhe MDIS, por është proceduar me pak vonesë, prandaj ka kaluar afati për shqyrtimin e buxhetit të propozuar për këto ministri dhe mundësia për paraqitjen e amendamenteve. Këtë hulumtim, tha se mund ta marrim si informatë të përgjithshme me shkrim, por mund ta prezantojë edhe përfaqësuesi i KDI-së, i cili është prezent në takim. Znj. Osmani njoftoi se ministrinë e linjës janë njoftuar nga komisioni se mund të paraqesin kërkesat e tyre buxhetore në komision, lidhur me projektbuxhetin e tyre për vitin 2018, por nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga ato. Propozoi që hulumtimi mbi analizën buxhetore të shqyrtohet nga anëtarët e komisionit, para shqyrtimit të dytë të Projektligjit për buxhetin e vitit 2018 në mbledhje plenare.

5. Përcaktimi i delegacionit të komisionit për pjesëmarrje në programin trajnues në selinë qendrore të NATO-s në Bruksel

Vjosa Osmani, bëri të ditur se Kuvendi i Kosovës ka pranuar një ftesë nga AP e NATO-s për program trajnues të një delegacioni të Kuvendit, i cili do të mbahet në Bruksel nga dt. 28-31 janar 2018. Duke pasur parasysh propozimet nga komisionet e tjera, kryetarja propozoi që nga KPJ të propozohen znj. Time Kadrijaj, z. Danush Ademi dhe znj. Doruntinë Maloku-Kastrati,

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisionit nxori këtë,

P ë r f u n d i m

Për pjesëmarrje sipas ftesës nga AP e NATO-s në programin trajnues të delegacionit të Kuvendit, i cili do të mbahet në Bruksel nga dt. 28-31 janar 2018, nga Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, propozohen:

1. Znj. Time Kadrijaj, nënkryetare e komisionit;
2. Z. Danush Ademi, nënkryetar i komisionit;
3. Znj. Doruntinë Maloku –Kastrati, anëtare e komisionit.

6. Të ndryshme

Vjosa Osmani njoftoi se ka kohë që i është bërë kërkesa ministrit të Jashtëm, për të raportuar në komision, por ende nuk i është përgjigjur ftesës. Ajo tha se është i nevojshëm raportimi i ministrit për shumë arsye, përfshirë edhe disa deklarata që ai i ka dhënë, për të cilat duhet të qartësojë qëndrimin e tij dhe të institucioneve që përfaqëson. Po ashtu, ndër çështje themelore për të cilat do të duhej të diskutojmë në raportimin e ministrit, tha se janë shumë tema që kanë të bëjnë me shërbimi diplomatik të Kosovës. Kërkoj nga anëtarët e komisionit që të deklarohen se kur do të ftohet ministri i Jashtëm, për të diskutuar për këto çështje në komision.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisionit nxori këtë,

P ë r f u n d i m

Zëvendëskryeministri dhe ministri i MPJ-së, z. Behgjet Pacolli, të ftohet për raportim në komision, në fillim të sesionit pranveror.

Vjosa Osmani, duke pasur parasysh praktikën e vendeve të tjera dhe bazuar në procesin e anëtarësimit në Partneritetin për Paqe dhe në NATO, propozoi që komisioni, në këtë fund vit, të

realizojë një vizitë zyrtare në ndonjërin nga kazernat e FSK-së. Ajo shtoi se realizimi i kësaj vizite, ka për qëllim diskutimin lidhur me raportet e FSK-së me NATO-n dhe me shtetet e veçanta anëtare të saj, por edhe lidhur me trajnimet që po bëhen dhe kontributin e NATO-s, në këtë drejtim. Vizita do të mund të realizohet më 27 ose 28 dhjetor 2017, në kazermën në Mitrovicë apo në Istog.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë,

P ë r f u n d i m

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, do të realizojë një vizitë pune në ndonjërin nga kazernat e FSK-së, më 27 ose 28 dhjetor 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisionit.

Kryetare e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu